



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-22469 dt. 17/06 2025

PROCESVERBAL

I mbledhjes së pestë të rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit, mbajtur më 29.05.2025, e cila filloi në orën 10:00.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani dhe deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 29 anëtarë.

Në mbledhje morën pjesë: Kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani (PDK), Labinot Halilaj (PDK), Arigon Sinani (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Laurita Muhadri - Bujupi (PDK), Hamit Kastrati (PDK), Blerina Gashi (PDK), Gani Krasniqi (PDK), Fatmir Baliu (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Valentina Leku (PDK), Manushaqe Mulaku (PDK), Kosovare Halilaj- Karaxha (PDK), Sali Dvorani (DD), Mehedin Salihu (DD), Hamit Haxhiu (DD), Jahir Hajdari (DD), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Marigona Bazaj (DD), Egzona Terdevci (VV), Filloreta Bujupi (VV), Selman Qallapeku, Arbër Halilaj (GREEN), Egzon Qorri (LDK), Beqir Kiqina (AAK), Muhamet Kurtaj (VV).

Munguan: Mirlinda Dvorani dhe Florentina Elezi-Veliu.

Të pranishëm ishin edhe: Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, Arben Shala nënkryetar i Komunës së Drenasit dhe drejtorë të drejtorive, si dhe përfaqësuesit e OSBE-së.

Mbledhja do të ketë

Rend dite:

1. Procesverbalin e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal mbajtur më datën 29.04.2025;
2. Propozim-vendim për financimin e projektit "HANDIKOS";
3. Rregullore për plotësim- ndryshim të Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba;
4. Propozim-vendim për rritjen e buxhetit nga tejkalimi i planit të të hyrave vetanake për vitin 2024 dhe bartjen në vitin 2025;
5. Propozim-vendim për bartjen e fondeve-të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin 2025;

6. Rregullore për plotësim- ndryshim të Rregullores për ndarjen e subvencioneve;
7. Propozim-vendim për shfuqizimin e përsëritshëm të Vendimit paraparak 02 nr.030/01-46219 për dhënien e pronave të paluajtshme të Drenasit/Glllogocit, në shfrytëzim afatgjatë personave fizikë, juridik (për 99 vjet) i miratuar me dt. 19.09.2024;
8. Propozim- vendim për shfuqizimin e Vendimit 02 nr.462/01-11634, Vendimit 02 nr.462/01-11636 dhe Vendimit 02nr.462/01-11637, të dt. 28.03.2025 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (për 35 vjet), pronat e paluajtshme të Komunës me procedurë të negociimit;
9. Propozim-vendim për formimin e komisionit për plotësim-ndryshim të Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba;
10. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, pasi prezantoi rendin e ditës, fjalën e merr Egzona Terdevci.

Egzona Terdevci, fillimisht me lejoni të përcjell vërejtjen time për çështjen e mikrofonve se po na shkakton veshhtësi për me e marrë fjalën sa i përket rendit të ditës kam dergu edhe propozim me shkrim për të hyrë si pikë e rendit të ditës “Rregullorja për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba”. Po më vjen mirë që keni reflektuar për formimin e komisionit për këtë rregullore, gjithashtu edhe pika të ndryshme të diskutohete si pikë e parë e rendit të ditës, sepse që dy seanca po shmangët diskutimi i kësaj pike duke u tërhequr asambleistet.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim rendin e ditës, prezent ishin 28 anëtarë të Kuvendit, rendi i ditës kaloi, me 26 vota për, 0 kundër, 0 abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën.

1.Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit, me dt. 29.04.2025. Pasi nuk pati vërejtje as diskutime, kryesuesi hodhi në votim pikën e parë të rendit të ditës, e cila kaloi me vota unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 2. Propozim-vendim për financimin e projektit “HANDIKOS”. Pasi nuk pati vërejtje as diskutime, hodhi në votim pikën e dytë, e cila kaloi me vota unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 3. Rregullore për plotësim-ndryshim të Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba.

Egzona Terdevci, meqnëse kjo pikë është shfuqizim i vendimit për shkak të vërejtjeve të MAPL-së, po e përcjell vërejtjen time me radhë që nuk po na përcjellen vendimet prej MAPL-së, kur vjen një vendim prej MAPL-së, duhet me na u përcjellë edhe neve letra e MAPL-së.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim pikën e tretë të rendit të ditës e cila kaloi me 26 vota për, 2 kundër, 0 abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 4. Propozim-vendim për rritjen e buxhetit nga tejkalimi i planit të të hyrave vetanake për vitin 2024

dhe bartjen në vitin 2025. Pasi nuk pati vërejtje, diskutime pika e katërt e rendit të ditës kaloi me 26 vota për, 2 kundër, 0 abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e 5. Propozim vendim për bartjen e fondeve-të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin 2025. Pasi nuk pati vërejtje, diskutime pika e pestë e rendit të ditës kaloi me 24 vota për, 2 kundër, 0 abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 6. Rregullore për plotësim-ndryshim të Rregullores për ndarjen e subvencioneve.

Egzona Terdevci, unë i kam disa propozime të ndryshimi i Rregullores për subvencione. Tek neni 3 pika 1.2 përkatesisht pika 1.2.1 që thotë se: "Vetëm një student nga familja mund të marrë bursë", propozoj që të modifikohet duke mos u përfillë ky kriter në rastin e studentëve që vijnë nga familjet e kategorive të veçanata, si ata me kushte të vështira ekonomike e kategoritë me nevoja të veçanata, kategori lufte dhe të tjera që mund të jenë relevante.

Tek neni 11 pika 6, propozoj që të shtohen si kategori edhe: "Viktimat e dhunës në familje", në funksion edhe të dokumentet që i kemi miratuar me herët kundër dhunës në familje, të neni 13 propozoj që të shtohen edhe: "Gratë që kanë pësuar dhunë në familje". Të pjesa që është për subvencionim të qirave, po ashtu propozoj që të rregullorja bazë për subvencione përkatesisht neni 14 subvencionet për arsim të shtohet si kategori edhe: Fëmijet e çerdheve familjet e të cilëve kanë të ardhura të ulëta", që është propozim i joni nga viti 2023.

Bekim Morina, zyrtar nga DKA-ja, tha se kjo rregullore për ndryshim- plotësim për ndarjen e subvencioneve që ka të bëjë edhe për subvencione në arsim edhe në drejtori të tjera ka ardhë si shkak i shumë kërkesave. Prej vitit 2022 ka qenë Rregullorja për dryshim - plotësim të rregullores të vitit 2017 edhe atëherë kanë qenë këto kategori në përjashtim të kategorisë fëmijë e dëshmoreve që është terheq ngase nuk ka fëmijë të dëshmorëve.

Mehdin Salihu, fëmijët e invalidëve të luftës edhe veteranët, ose i keni vlerësuar me zero pikë, ose hiq nuk po i shoh.

Bekim Morina, tha se nuk është terheq ajo kategori, por janë në rregulloren e vitit 2022, shikoje këtë rregullore nuk është e nevojshme më hyrë vetëm ato që hiqën ose shtohen.

Egzona Terdevci, z. Morina e keqkuptoi pyetjen time. Unë e kam të qartë që janë kategoritë e luftës, por e pata fjalën të studentët që përjashtohen dy prej familjes mos me e llogaritë këtë kriter në rastin kur kemi të bëjmë me familjet me kushte të vështira dhe kategori tjera të ndjeshme.

Po ashtu me qenëse je i fushës se arsimit po besoj që mundemi me marr përgjigje me përfshi si kategori tek neni 14 edhe fëmijët e çerdheve familjet e të cilëve kanë të ardhura të ulëta, pra kanë nevoja financiare me të mëdha.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ndryshimi i rregullores në tanësi është ndryshim që ne po e formojmë komisionin sot, ndryshimi është të bursat që i ka kërku DKA-ja dhe drejtoritë tjera që është e ngutëshme dhe unë kërkoj prej grupit tonë më votu për tana propozimet.

Egzona Terdevci, a mundet që propozimet që i kam bërë me u ndyshu në një seancë tjetër, sepse të gjitha janë propozime të vlefshme dhe të nevojshme.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, gjithmonë ka mundësi nëse e keni shumicën e asamblesë, në çdo seancë ka mundësi me bërë ndryshime të rregullores.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim pikën e gjashtë të rendit të ditës e cila kaloi me 27 vota për, 0 kundër, 0 abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 7. Propozim - vendim për shfuqizimin e përsëritshëm të Vendimit paraparak nr.02 Nr.030/01-46219 për dhënien e pronave të paluajtshme të Drenasit/Glllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizikë, juridik(për 99 vjet) i miratuar më dt. 19.09.2024.

Egzona Terdevci, edhe këtë diskutim kisha dashur me e bërë me herët po materialet i morëm sot kur erdhëm në seancë, prap po përseritet e njëjta praktikë. Sa herë që na vijnë materialet që duhet me i shfuqizuar, ishte dashur me na ardhë edhe vendimi i MAPL-së, për këtë çështje.

Më lejoni ta përsëris që në seancën e dt. 28.03.2025, unë i kam thënë z.Lladrovci që nuk mundet me dhënë prona që ka kaluar verifikimin paraparak prej asamblesë, me negociim nganjëher është mire me i marrur parasysh edhe rekomandimet tona si asambleist që mos me u ballafaqu vazhdimisht me kthime të vendimeve prej MAPL-së.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, e nderuar znj.Terdevci, unë vendimet i kam marr në përputhje me ligjet e aplikushme, ne sot po i marrim këto dy vendime për shkak të pasojave që mundet me i pas Komuna në grantin e performancës, përndryshe po e dërgoj në konflikt administrativ edhe e shohim kush po e fiton betejën. Nuk është një vendim kthim i ligjshmërisë të aktit të Komunës që e ka bërë ndryshe, një vendim ndryshe një vendim tjetër MAPL-ja edhe do të shohim kush e fiton në gjykatën e konfliktit administrativ. Unë e kam obligim me pru me shfuqizu, ju jeni ketu dhe vendosni ju.

Egzona Terdevci, faleminderit për përgjigjen, unë të inkurajojë me e dërgu edhe në gjykatë se ligji është shumë i qartë, dërgoje edhe e sheh kush e fiton.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, Pasi nuk pati vërejtje as diskutime, hodhi në votim pikën e shtatë të rendit të ditës, e cila kaloi me 27 vota për, 2 kundër, 0 abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 8. Propozim-vendim për shfuqizimin e Vendimit 02 nr.462/01-11634, Vendimit 02 nr.462/01-11636 dhe

Vendimit 02nr.462/01-11637, të dt. 28.03.2025 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (për 35 vjet) pronat e paluajtshme të Komunës me procedurë të negocimit.

Kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani, hodhi në votim pikën e tetë të rëndit të ditës, e cila kaloi me 27 vota për, 2 kundër, 0 abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 9. Propozim-vendim për formimin e komisionit për plotësim-ndryshim të Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ekzekutivi propozon Fluida Nika kryetare nga ekzekutivi, Shehrije Mustafa anëtare nga ekzekutivi, Lumnije Prenku, anëtare nga ekzekutivi dhe Arben Kuliqi përfaqësues nga shoqëria civile anëtar faleminderit.

Kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani, ftoi grupet që të propozojnë nga një anëtar, nga PDK-ja, propozohet Labinot Halilaj, nga grupi i DD-së, propozohet Mergim Pirraku, nga VV-ja, propozohet Egzona Terdevci.

Kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani, Komisioni për plotësim-ndryshim të Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba i cili ka për detyrë të bëjë plotësim-ndryshim të Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba, duke e harmonizuar këtë rregullore me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve, të cilin komision e përbejnë tre (3) anëtar nga ekzekutivi i Komunës të cilët i propozon Kryetari i Komunës, tre (3) anëtar nga Kuvendi i Komunës nga subjektet e ndryshme të përfaqësuara në Kuvend dhe një (1) anëtar nga shoqëria civile si vijon:

1. Fluida Nika - kryetare nga ekzekutivi;
2. Shehrije Mustafa - anëtare nga ekzekutivi;
3. Lumnije Prenku - anëtare nga ekzekutivi;
4. Labinot Halilaj - anëtar nga Kuvendi;
5. Mërgim Pirraku - anëtar nga Kuvendi;
6. Egzona Tërdevci - anëtar nga Kuvendi;
7. Arben Kuliqi - përfaqësues nga shoqëria civile, anëtar.

Kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani, hodhi në votim pikën e nëntë të rëndit të ditës edhe kaloi me 27 vota për, 2 kundër, 0 abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 10. Të ndryshme.

Egzona Terdevci, z.Lladrovci, unë kam inicuar të Agjensia për menaxhimin e komplekseve memoriale një kërkesë që të rregullohen dy varret e të pagjeturve të fshatit Shtuticë, që janë varrosë me dt. 12 .10.2024 të z.Besim Berisha dhe Agim Sylaj, po drejtori i agjensionit më ka kërkuar që kërkesa me ardhur përmes Komunës, pra prej

juve si Kryetar i Komunës.

Deshta me pyet, nëse ka mirëkuptim që një kërkesë e tillë me u adresu prej jush të instuticioni përkatës. Dhe çështja e dytë a jeni të vetëdijshëm për shkeljen e ligjit që ju keni bërë për konfliktin e pastër të interesit kur e keni zgjedhë zyrtar të lartë në bujqësisë vetë drejtoreshën e bujqësisë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, Egzon për pyetjen e parë, unë bëjë kërkesë, sepse e kam edhe obligim ligjor dhe më vjen mirë që kryesuesi apo kryeshefi i agjensionit tani po i merr edhe po i kërkon pëlqimet se dikur kanë marrë vendime dhe i kanë dërgu çdokujt, sigurisht me çdo respekt për dy viktimat e luftës, në këtë rastë do të bëjë kërkesë sa po të me jepet mundësia do ta bëjë kërkesën.

Sa i përket konfliktit të interesit nuk kemi asnjë lloj të konfliktit të interesit, janë proceduar që unë as nuk kam të drejtë dhe as nuk bëjë diskriminim nadj askujt.

Egzona Terdevci, faleminderit që pranove kërkesën për me e adresua çështjen e varrezave e vlesroi shumë përkushtimin tënd në këtë pjesë. Sa i përket çështjes tjetër të drejtoreshës, aty kanë qenë dy aplikantë, po aplikanti tjetër pa dyshim që nuk vjen në intervistë kur e sheh që vet drejtoresha që e ka shpall konkursin i din krejt procedurat e njehë komisionin mundet me i pasë pyetjet dhe krejt informacionet, është pjesë e konkursit ndoshta edhe mundet me qenë e ligjshme dhe ende nuk e kam dërguar në instuticione përkatëse, por e ndershme nuk është asnjëherë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, znj. Terdevci, nuk e din t'i pse nuk ka ardh ai i dyti edhe a e kish fitu vendin a se kish fitu, sepse kësaj i thojnë paragjykim që po e thuani ju.

Mehdin Salihu, kam dy pyetje për drejtoreshën Krapë edhe drejtorin Gruda, drejtoreshë numri i të prekurve me kancer është në rritje i keni statistikat. Më inetereson këtë vite a keni mundë me ndarë buxhet për këtë kategori, sepse këta nuk mund të ja dalin vetë, kurse zjarrfikësit nuk i kanë marrë që tre muaj kujdestaritë, a ka shpresë që do të rregullohet kjo çështje.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, z. Mehdin, qeverisja jonë komunale i ka ndarë mjetet vazhdon të i ndaj subvencione për këtë kategori buxheti i Kryetarit dhe drejtorit e tjera.

Drejtori i Emeregjencave Nexhmedin Gruda, tha se sa i përket pyetjes tënde, ne i kemi përcjellë për pagesa, mirëpo për çështje buxhetore ato nuk janë bërë për dy muajt e kaluar, po në mënyrë retroaktive do t'i bëjmë pagesat.

Fatmir Baliu, kisha kërkuar prej Kryetarit më bërë një kërkesë për rrethojën e varrezave në fshatin Shtuticë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, në rregull do të bëjë këtë kërkesë.

Arber Halilaj, pozicioni im në asamblen komunale është si asambleist i GREEN, unë jam pikërisht në vijën të cilën e ka përcaktuar Kryetari, z. Drenori.

Më gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit, të dt. 29.04.2025 mund ta ndiqni në ueb faqen zyrtare të Komunës, në rrjetin social.
<https://ëëë.facebook.com/share/v/18oAAjgGFm/>


Mbledhja përfundoi në ora 11:10.

Procesmbajtësja



Fakte Hoti

Lekturoi



Nikelinda Bujupi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Bekim Lestrani